



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 03/L-092**

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 02/L-20 PËR KËRKESAT  
TEKNIKE PËR PRODUKTE DHE VLERËSIM TË KONFORMITETIT**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Duke pasur parasysh kërkesën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-20 Për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit me qëllim të krijimit të kushteve që ligji të gjejë zbatueshmëri të plotë,

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 02/L-20 PËR KËRKESAT  
TEKNIKE PËR PRODUKTE DHE VLERËSIM TË KONFORMITETIT**

**Neni 1**

Në nenin 1 të ligjit pika (v), fjalët “të autorizuar” hiqen dhe zëvendësohen me fjalën “kompetente”.

**Neni 2**

Në nenin 3 të ligjit, pas pikës (xi) shtohen këto përkufizime si vijon:

**“Importues”** është çdo person fizik ose person juridik i regjistruar në Republikën e Kosovës i cili prodhimet nga vendet e tjera i plasojnë në tregun e territorit të Republikës së Kosovës.

**“Standard evropian”** është një dokument vullnetar, i hartuar me konsensus dhe i miratuar nga një organizëm i njohur standardizimi, i cili ofron për përdorim të përbashkët dhe të përsëritur, rregulla, udhëzime apo karakteristika për aktivitete apo rezultatet e tyre me qëllim të arritjes së një shkalle optimale rregulli në një kontekst të dhënë.

Në nenin 3 të ligjit pika (x) ndryshohet dhe plotësohet teksti si vijon:

**“Organi për vlerësimin e konformitetit”** për prodhuesin, përfaqësuesin e tij të autorizuar dhe importuesin, nënkupton laboratorin e pavarur, organin e certifikuar, organin mbikëqyrës ose organin tjetër që bashkëvepron në procedurën e vlerësimit të konformitetit.

### Neni 3

Në nenin 6 të ligjit pika (ii) ndryshohet dhe plotësohet teksti si vijon:

(ii) Nxjerr apo siguron deklaratën e konformitetit, raportin e testimit si dhe certifikatën e konformitetit (në tekstin e mëtejshëm: dokumentin për konformitetin).

### Neni 4

Paragrafit 1 të nenit 7 i shtohet teksti në vijim:

Në rastet ku shënjimi i produktit nuk është i mundur për shkak të natyrës së tij, shenja e konformitetit duhet të vendoset në paketim dhe në dokumentet përcjellëse, kur kjo kërkohet me kërkesat teknike.

### Neni 5

Në paragrafin 2 të nenit 8 hiqen pikat “(i), (ii), (iii) dhe (iv)”, shtohet teksti me pikat si vijon:

(i) Vlerësimi i konformitetit në kushte të specifikuara, i kryer nga prodhuesi;

(ii) Vlerësimi i konformitetit të një mostre të produktit i kryer nga organi për vlerësimin e konformitetit;

(iii) Vlerësimi i konformitetit nëpërmjet të cilit organi për vlerësimin e konformitetit ekzaminon karakteristikat e produktit dhe verifikon me zgjedhje, sipas rastit, përputhjen e produkteve me kërkesat e përcaktuara;

(iv) Vlerësimi nga një organ për vlerësimin e konformitetit i sistemit të cilësisë së prodhimit ose të komponentëve të tij në ndërmarrje dhe kryerjen e mbikëqyrjes për funksionimin e duhur të sistemit;

(v) Verifikimi i përputhshmërisë së produkteve me një tip produkti të certifikuar, ose me kërkesat e specifikuara, të cilat janë kryer nga prodhuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar, personi që vendos produktin në treg apo në shërbim ose nga një organ për vlerësimin e konformitetit për çdo produkt ose për një mostër të përzgjedhur statistikisht;

(vi) Verifikimi nga një organ për vlerësimin e konformitetit për përputhshmërinë e çdo produkti me kërkesat e përcaktuara;

(vii) Mbikëqyrja nga një organ për vlerësimin e konformitetit dhe të funksionimit të duhur të sistemit të cilësisë në ndërmarrje dhe nëse është e nevojshme, vlerësimin e konformitetit të produktit me kërkesat e rregullave teknike në fazën e projektimit;

(viii) Vlerësimin e aktiviteteve lidhur me prodhimin e produkteve;

(ix) Procedura të tjera të vlerësimit të konformitetit, nëse është e nevojshme, duke përfshirë aktivitetet e një organi të akredituar ose të një personi tjetër.

## Neni 6

Ne nenin 10 pika (vi) pas tekstit ekzistues shtohet teksti si vijon:

në pajtim me rregullat teknike dhe / ose rregullat e tjera që janë në fuqi.

## Neni 7

Në paragrafin 1 të nenit 16 shuma prej “1.000€ deri 5.000€” zëvendësohet me shumën “**3.000€ deri 5.000€**”, ndërsa shuma prej “250€ deri 500€” zëvendësohet me shumën “500€ deri 1500€”.

Në paragrafin 2 të nenit 16 shuma prej “100€ deri 300€” zëvendësohet me shumën prej “500€ deri 1000€”.

## **Neni 8**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë ditë (15) pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 03/L-092**  
**12 shkurt 2009**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

---

**Jakup KRASNIQI**